



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.368/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, me objekt të çështjes, mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, pa autorizim nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ), në Junik, në seancën e panelit, të mbajtur me datë 12.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hidhet** e palejuar ankesa Anr 368/2021 e datës 11.02.2021, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë.

## A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka paraqitur ankesë në PZAP, më datë 11.02.2021, me të cilën pretendon se subjekti politik AAK më datë 08.02.2021, ka mbajtur tubim elektorale të pa autorizuar në KKZ, e i cili tubim është mbajtur rreth orës 18.00, në palestrën sportive në lagjen Berishë të Junikut. Kryesuesi i KKZ-së, z. Xhavit Gaxherri ka shfaqur anshmëri politike, diqka e paprecedent për një kryesues të KKZ-së, që sipas parashtruesit të ankesës duhet ta kryejë detyrën në mënyrë profesionale. Më tutje theksohet se i njëjti në homazhet e të dielës që z. Albin Kurti bëri tek shtatorja e Edmond Hoxhës në qendër të Junikut e cilësoi si tubim politik dhe bëri ankesë në PZAP rreth kësaj çështje. Të drejtën e ankesës është e drejtë që nuk mund ti mohohet askujt por në cilësinë e kryesuesit të KKZ-së kjo është anshmëri puro politike kur njëri subjekt e dënon e për tjetrin i mbyll sytë. Në vazhdim të ankesës pretendojnë se Tubimin e mbajtur dje nga ana e AAK-së, në palestrën e Junikut, z.Xhavit Gaxherri nuk e ka raportuar në KQZ apo PZAP. Lëvizja Vetëvendosje, Qendra Junik, e sheh si pabarazi ndaj subjektit të tyre sepse cilësojnë që kryesuesi i KKZ-së duhet të ketë qasje të barabartë dhe të drejtë ndaj të gjitha subjekteve njëjtë. Pika dy e kësaj ankese lidhur me tubimin

e AAK-së të mbajtur me datë 08.02.2021 në palestrën sportive të Junikut. Në këtë tubim siq shihet në fotografat e bashkangjitura si dëshmi për ta bazuar ankesën, në këtë tubim pretendojnë se kanë qenë mbi 30 persona. Pika 24 e Masave për aktivitetet publike e thotë shumë qartë se "Në hapsira të mbyllura ndalohet grumbullimi i qytetarëve në numër prej më shumë se 30 personave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Me dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafi 2 i Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, përcaktohet se: "Nëse ZLKZ-ja, ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës hasin në tubim publik të paautorizuar, ata duhet të informojnë PZAP për hollësitë e tubimit publik: për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik".

Paneli vlerëson se nga dispozita e lart cituar, rezulton se të drejtën për ta informuar PZAP, lidhur me rastet e mbajtjes së tubimeve elektorale-publike pa autorizim, gjatë fushatës zgjedhore, e kanë vetëm ZLKZ-ja ose Zyrtaret e Policisë së Kosovës, e që në këtë rast ankesa është paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e cila nuk ka legjitimitet për të paraqitur ankesa të kësaj natyre, andaj si e tillë është hedhur e pa lejuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2015 të PZAP-it, nenin 6 paragrafi 4, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 368/2021 më datë 12.02.2021

**Kryesues i Panelit**

Burim Ademi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.